



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më . . . 2020

**PLATFORMË VLERËSIMI**

**A. QËLLIMI**

Vlerësimi i masave të marra nga shkolla për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore.

**B. BAZA LIGJORE**

1. Ligji nr. 69, datë 21.06.2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
3. Urdhër i MASR-së, nr. 267, datë 15.05.2018, “Për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të klasave 1, 2, 4, 5, 6, 7, 9 dhe 10 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2018-2019”.
4. Udhëzimi i MASR-së, nr. 18, datë 20.08.2019, “Për vitin shkollor 2019-2020 në sistemin arsimor parauniversitar”.

**C. DREJTIMET E VLERËSIMIT**

- Shkolla ka marrë masa për përzgjedhjen e teksteve shkollore.
- Shkolla ka marrë masa për shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore.

**D. METODOLOGJIA**

- Takime me drejtuesit e shkollës, komisionin e administrimit, mësues, nxënës dhe prindër.
- Verifikimi i procedurës për përzgjedhjen e teksteve shkollore.
- Vëzhgimi i njësive tregtare të shitjes së teksteve shkollore.
- Takim me drejtorinë e shkollës dhe stafin mësimor për diskutimin e gjetjeve.

**E. INSTITUCIONI QË DO TË VLERËSOHET**

- Gjimnazi/shkolla 9-vjeçare “ \_\_\_\_\_ ”, ZVAP-ja \_\_\_\_\_

**F. KOHA E REALIZIMIT TË VLERËSIMIT**

- \_\_-\_\_-\_\_.2020

## **G. PËRBËRJA E EKIPIT TË VLERËSIMIT**

1. .... drejtues i ekipit
2. .... anëtar

## **H. RAPORTI I VLERËSIMIT DO T’I DORËZOHET**

- Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
- Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar
- Drejtorisë Rajonale Arsimore Parauniversitare, përkatëse
- Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare, përkatëse
- Shkollës së vlerësuar.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**GERTI JANAQI**

**TREGUESIT E VLERËSIMIT**

Qëllimi i këtij instrumenti është vlerësimi i masave të marra nga shkolla për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore.

**Shkolla:** \_\_\_\_\_

**ZVAP:** \_\_\_\_\_

**DRAP:** \_\_\_\_\_

Ju lutem, shënoni me X zgjedhjen tuaj në kutizën përkatëse. Nëse ju mendoni se është e nevojshme, mund të bëni komente për zgjedhjen.

TREGUESIT	PËRSHKRUESIT PRAKTIKË	NIVELET E VLERËSIMIT				KOMENTE
		1	2	3	4	
1.Shkolla ka marrë masat për përzgjedhjen e teksteve shkollore.	1.1 Shkolla ka ngritur Komisionin e Administrimit të përzgjedhjes së teksteve shkollore, të përbërë nga tre anëtarë (kryetari, sekretari dhe një anëtar).					
	1.2. Shkolla disponon dokumentacionin për procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollore, në përputhje me detyrat e Komisionit të Administrimit, përkatësisht: - katalogun e librave; - vendimin, datën, orën dhe vendin e mbledhjes për përzgjedhjen e teksteve; - procesverbalet e komisioneve lëndore; - tabelën përmbledhëse origjinale në tri kopje, të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KA-së.					
	1.3. Mësuesit e shkollës janë grupuar sipas komisioneve lëndore.					
	1.4. Shkolla ka të dokumentuara detyrat dhe përgjegjësitë e mësuesve të klasave/komisioneve lëndore të reflektuara në procesverbalet e përzgjedhjes së teksteve.					
	1.5. Drejtoria e shkollës disponon: - katalogun e librave; - ekzemplarët e teksteve shkollore të dërguara nga botuesit; - fletën e inventarit të bibliotekës për ekzemplarët e teksteve shkollore të dërguara nga botuesit;					

	- tabelën përmbledhëse përkatëse.					
	<b>1.6.</b> Dokumentacioni i administrimit të teksteve shkollore është ruajtur në arkivin e shkollës për 2 vite kalendarike.					
	<b>1.7.</b> Shkolla ka përzgjedhur tekstet shkollore që nuk kanë si autorë, redaktorë, korrektues, ilustrues, mësues ose drejtues të shkollës.					
	<b>1.8.</b> Shkolla, gjatë përzgjedhjes së teksteve shkollore, nuk ka lejuar asnjë veprimtari të botuesve/distributorëve, që kanë për qëllim publicitetin e teksteve të tyre.					
2.Shkolla ka marrë masa për shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore.	<b>2.1.</b> Shitja e teksteve shkollore bëhet nëpërmjet njërive tregtare të shitjes ose në pika të tjera shitjeje pranë shkollave, nga subjekte të licencuara.					
	<b>2.2.</b> Drejtoria e shkollës, me kërkesën e botuesve/distributorëve, ka vënë në dispozicion falas një ose dy ambiente për shitjen e teksteve shkollore.					
	<b>2.3.</b> Të gjitha tekstet shkollore që shiten kanë hologramën e MASR-së.					
	<b>2.4.</b> Drejtoria e shkollës ka publikuar në një vend të dukshëm për nxënësit dhe prindërit, listën e teksteve shkollore që do të përdoren për vitin shkollor, emrin e botuesit dhe çmimin.					
	<b>2.5.</b> Subjektet e licencuara për shitjen e teksteve shkollore nuk u shesin nxënësve tekste që nuk i përmban katalogu.					

**Ekipi i vlerësimit**

.....  
.....

**Drejtori i shkollës**